



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 2 qershor 2022
Nr. ref.: RK 1999/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI83/21

Parashtrues

Çerkin Ibishi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me
Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
AC-I-20-0254, të 11 marsit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Çerkin Ibishi, me vendbanim në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS), AC-I-20-0254, të 11 marsit 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 maj 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban, anëtarë.
7. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr. KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
8. Më 24 maj 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullin 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të

Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimin e Gjykatës nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 11 maj 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune pranë Ndërmarrjes Shoqërore Gazeta “Rilindja” në periudhën nga muaji nëntor i vitit 1974 deri në muajin shkurt të vitit 2002.
13. Më 22 shkurt 2017, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) nxori Vendimin për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes NSH Gazeta “Rilindja”.
14. Më 12 prill 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi një kërkesë në AKP për dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës.
15. Më 23 maj 2017, Autoriteti i Likuidimit, përmes Vendimit PRN142-0415, refuzon kërkesën e parashtruesit të kërkesës për dëmshpërblim. Autoriteti i Likuidimit kishte arsyetuar se parashtruesit të kërkesës nuk mund t'i njihet e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, siç parashihet me nenin 40 paragrafi 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, sepse pushimi i marrëdhënies së punës nuk ka ndodhur si rrjedhojë e veprimit të ndërmarrë nga AKP-ja, përkatësisht nuk ka ndodhur për shkak të likuidimit.
16. Më 20 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në DHPGJS kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN142-0415. Në këtë ankesë, parashtruesi i kërkesës kërkon që të obligohet AKP-ja që në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nga NSH Gazeta “Rilindja” më 21 shkurt 2002, t’ia paguajë shumën prej 1200 euro dhe mes tjerash pretendon se ata janë larguar kolektivisht nga puna më 21 shkurt 2002 dhe rrjedhimisht zbatohet Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27, përkatësisht neni 12 paragrafi 2 (dh).
17. Më 25 korrik 2017, AKP-ja dorëzoi “Mbrojtje ndaj ankesës” së parashtruesit të kërkesës. AKP-ja, *inter alia*, thekson se neni 40 paragrafi 1.6.2 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në i jep të drejtë vetëm personave që janë pushuar nga puna për shkak të ndonjë veprimi të AKP-së, e në rastin e parashtruesit të kërkesës, theksoi se i njëjti nuk ka qenë në marrëdhënie pune në NSH “Rilindja” shumë vite para likuidimit, përkatësisht parashtruesi nuk ka ofruar shërbime pune për ndërmarrjen që nga viti 2002.

18. Më 21 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigjen e tij ndaj pretendimeve të AKP-së dhe theksoi se ai i konteston pretendimet e saj, duke theksuar, ndër të tjera, se në pajtim me nenin 12 paragrafi 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27, në rast të largimit të shkallës së gjerë nga puna, zbatohen këto dispozita: *“(dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Ky dëmshpërblim duhet të paguhet në ditën e shkëputjes së kontratës së punës, sipas shkallëve të mëposhtme: (i) prej 1-4 vjet stazh pune 1 pagë mujore; (ii) prej 5-9 vjet stazh pune 2 paga mujore; (iii) prej 10-19 vjet stazh pune 3 paga mujore; (IV) prej 20-29 vjet stazh 4 paga mujore; (V) prej 30 e më tepër 5 paga mujore”*.
19. Më 31 gusht 2017, AKP-ja dorëzoi “Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes në mbrojtje”, duke theksuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova apo argumente të reja juridike, dhe përsëriti se marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës nuk është ndërprerë si rrjedhojë e veprimit të AKP-së.
20. Më 28 shkurt 2020, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit C-VI-17-0291, vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar dëshmi me të cilat do të mbështeste argumentet e tij dhe nuk ka arritur të dëshmonte që atij, në bazë të shkresës së dorëzuar për ndërprerje të kontratës së punës nga AKP-ja në shkurt 2002, i takon e drejta e dëmshpërblimit për shkëputje të parakohshme të kontratës. Sipas DHPGJS-së, në bazë të nenit 40 paragrafi 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtori gëzon të drejtën e dëmshpërblimit nëse (a) kontrata e punës është ndërprerë si rrjedhojë e vendimit për likuidim më 22 shkurt 2017, kur ka filluar procedura për likuidimin e NSH Gazeta “RILINDIJA”; (b) pushimi nga puna ka ardhur si rrjedhojë e Vendimit të AKP-së; dhe (c) pushimi nga puna ka ardhur për shkak të veprimit të Agjencisë, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjen, likuidimin, etj.; ndërsa parashtruesi i kërkesës në rastin konkret nuk i ka plotësuar këto kushte.
21. Më 12 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktgjykimit (C-IV-17-0291) të Kolegjit të Specializuar, duke pretenduar (i) shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës thekson se sipas praktikës gjyqësore pagesa pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës parashihet me ligj. Ai pretendon se në rastin kur ndërpritet marrëdhënia e punës, duhet të lëshohet aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe thekson se ky vendim nuk ekziston. Sipas pretendimeve të tij, *“Kjo dëshmon se ankuesit nuk iu ka ndërprerë marrëdhënia e punës deri me futjen në likuidim të ndërmarrjes”*.
22. Më 11 mars 2021, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit AC-I-20-0254, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin (C-IV-17-0291) e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

23. Kolegji i Apelit i DHPGJS-së theksoi se duhet të vlerësohen provat e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, përmes të cilave ai dëshmon a i plotëson kriteret që atij t'i njihet e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Lidhur me këtë, Kolegji i Apelit arsyetoi se parashtruesi i kërkesës ka vërtetuar se ai ka qenë punëtor i NSH "Rilindja", por *"me asnjë provë ai nuk ka dëshmuar se AKP-ja atij ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë veprim të saj si rezultat i fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së, për të pasur të drejtë, që në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, t'i njihet e drejta e kompensimit të 3 pagave në shumë prej 1.200,00 euro në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. [...]"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara në nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.
25. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se ky nen, *"çdo qytetari të Republikës së Kosovës i garanton të drejtën e pronës, shfrytëzimit të pronës dhe se askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Të ardhurat personale janë pjesë përbërëse e pronës së çdo qytetari, prandaj me mohimin e tyre nga e paditura është shkelur neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës"*.
26. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *"Poashtu me mohimin e të ardhurave nga puna është shkelur edhe e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit e garantuar me dispozitat e nenit 49 të [Kushtetutës së] Republikës së Kosovës. E drejta e punës është e garantuar edhe me dispozitat e konventës ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e personave"*.
27. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron se Rregullorja e UNMIK-ut nuk është e aplikueshme në rastin e tij duke theksuar se, *"AKP është pasuese e Agjencisë së Mirëbesimit e cila ka punuar dhe punon sipas Rregullores së UNMIK-ut, e jo në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, prandaj edhe për këtë arsye konsiderojmë se aktgjykimet janë jolëndore, sepse janë marrë nga organi jokompetent"*.
28. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë: *"Dëshiroj të anulohen aktgjykimet e ankimuara dhe të aprovohet padia"*.

Dispozitat relevante ligjore

SHTOJCA E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 40

Prioritetet e kërkesave dhe interesave

“1. Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim:

[...]

1.6. kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim:

1.6.1. kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person;

1.6.2. kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në;

[...]

RREGULLORE E UNMIK-ut NR. 2001/27 PËR LIGJIN THEMELOR TË PUNËS NË KOSOVË

Neni 12

Shkëputja e kontratës së punës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje

[...]

12.2 Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(a) para se t'i zbatojë ndryshimet e tilla, punëdhënësi i njofton me shkrim punonjësit dhe, sipas rastit, edhe sindikat(at)ën e punonjësve lidhur me ndryshimet e planifikuara dhe me rrjedhojat e tyre, duke përfshirë edhe numrin dhe kategorinë e punonjësve që duhet të largohen nga puna, masat që duhet të ndërmerren për zbutjen e pasojave të shkaktuara nga këto ndryshime si dhe të drejtat e punonjësve të parapara në kontratën e punës dhe, sipas rastit, edhe në marrëveshjen kolektive;

(b) punëdhënësi i njofton punonjësit e tij me shkrim lidhur me shkëputjen e kontratës së punës së paku 3 muaj para datës së shkëputjes;

(c) punëdhënësi e njofton me shkrim entin për punësim për largimin e punonjësve nga puna ose organin që vjen pas tij në mënyrë që ai të ketë mundësi t'iu ofrojë ndihmë atyre për të gjetur punësim tjetër;

(ç) punëdhënësi ndërmerr masa adekuate për kufizimin e numrit të punonjësve që do të largohen nga puna duke e kufizuar ose ndërprerë punësimin e punonjësve të rinj, duke bërë risistemimin e brendshëm të punonjësve, duke e kufizuar punën jashtë orarit, duke i zvogëluar orët e

punës, duke ofruar riaftësim profesional si dhe duke nxitur ngritjen e shkathtësive;

(d) me rastin e përcaktimit të numrit dhe kategorisë së punonjësve për largim nga puna, punëdhënësi duhet ta marrë parasysh efektshmërinë e punonjësit në punë, aftësimin dhe shkathtësitë profesionale, përvojën e punës, postin, kategorinë dhe llojin e punës, stazhin, moshën si dhe kriteret tjera që mund të parashihen me kontratë të punës dhe, sipas rastit. edhe me marrëveshje kolektive;

(dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t'i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

(i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;

(ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;

(iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;

(iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;

(v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore dhe

(e) në rast se punëdhënësi rifillon me punësim brenda një periudhe kohore prej 2 vitesh nga data e shkëputjes së kontratës së punës, përparësi kanë punonjësit e larguar nga puna me kualifikime të njëjta. [...]

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS

Neni 70

Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;

1.2. i punësuari nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;

1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. dhe 1.2., të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;

1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:

1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe

1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.

1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;

1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:

1.6.1. i punësuari është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;

1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën-paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuari ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuari duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim.

3. Punëdhënësi duhet që të mbajë takim me të punësuarin për t'ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t'ia dorëzojë paralajmërimin, i punësuari ka të drejtë që të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vet.

4. Marrëveshjet Kolektive ose Aktet e Brendshme të Punëdhënësit mund t'i specifikojnë llojet e keq sjelljeve ose të shkeljeve të detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuari t'i nënshtrohet ndërprerjes të kontratës së punës pa periudhë paralajmërimi, qoftë pas një rasti të vetëm dhe qoftë pas shkeljeve të përsëritura.

Neni 71

Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;

1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Neni 72

Procedura para ndërprerjes së Kontratës

1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje.

2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit.

3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës.

[...]

Neni 76

Largimet kolektive nga puna

1. *Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas nën-paragrafit 1.1. të paragrafit 1 të nenit 70, të këtij ligji ku përfshihen së paku 10% të të punësuarave por jo me pak se njëzet (20) të punësuar, të larguar brenda intervalit kohor prej gjashtë (6) muajsh, konsiderohet si largim kolektiv nga puna;*
2. *Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna, zbatohen dispozitat nga paragrafi 3. i këtij neni;*
3. *Para se t'i zbatojë ndryshimet e tilla, punëdhënësi i njofton paraprakisht me shkrim një (1) muaj më parë të punësuarit dhe sindikatën e të punësuarve, nëse janë të anëtarësuar në sindikatë, lidhur me ndryshimet e planifikuara dhe me pasojat e tyre, duke përfshirë:*
 - 3.1. *numrin dhe kategorinë e të punësuarve që duhet të largohen nga puna;*
 - 3.2. *masat që duhet të ndërmerren punëdhënësi, nëse ka të tilla, për ti zbutur pasojat e largimit kolektiv, përfshin:*
 - 3.2.1. *kufizimin ose ndërprerjen e punësimit të punëtorëve të rinj;*
 - 3.2.2. *risistemimin e brendshëm të të punësuarve;*
 - 3.2.3. *kufizimin e punës jashtë orari;*
 - 3.2.4. *zvogëlimin e orëve të punës;*
 - 3.2.5. *ofrimin e riaftësimit profesional;*
 - 3.2.6. *të drejtat e të punësuarve të parashikuara me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose me Kontratën e Punës.*
4. *Me njoftimin e bërë sipas paragrafit 3. të këtij neni, punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarve me një periudhë të paralajmërimit sipas nenit 71 të këtij ligji.*
5. *Punëdhënësi e njofton me shkrim Zyrën për Punësim, lidhur me largimin e të punësuarve nga puna, në mënyrë që ZP-ja të ketë mundësi t'u ofrojë ndihmë atyre për të gjetur punësim tjetër.*
6. *I punësuari nuk mund të largohet nga puna, derisa punëdhënësi mos t'i ketë paguar atij një kompensim të menjëhershëm në para.*
7. *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle:*
 - 7.1. *nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore;*
 - 7.2. *nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore;*
 - 7.3. *nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore;*
 - 7.4. *nga njëzet (20) deri në njëzetënëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore; dhe*
 - 7.5. *nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore.*
8. *Nëse, brenda një periudhe prej një (1) viti nga ndërprerja e kontratës së punës të të punësuarve në bazë të këtij neni, punëdhënësi ka nevojë për angazhimin e punësuarve me kualifikime ose trajnime të njëjta, punëdhënësi nuk duhet të angazhojë persona të tjerë para se të ofrojë punën punonjësve të cilëve iu janë ndërprerë kontratat.*
9. *Rastet kur të punësuarit e larguar nga puna për shkak të falimentimit dhe riorganizimit të administruar nga gjykata, nuk i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
31. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

- “1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
- 2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

32. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
33. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke

përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 përcakton që:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]*

*(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
[...]*

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

34. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KI04/21, parashtuese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26, gjithashtu, shih, rastin KI175/20, parashtuese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
35. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri në 284, gjithashtu, shih rastin KI04/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).
36. Në këtë kontekst dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht, për të vlerësuar në rrethanat e këtij rasti, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht, do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës,

ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin K104/21, cituar më lart, paragrafi 28).

37. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës në thelb pretendon dy lloje të shkeljeve, përkatësisht: i) shkeljet e pretenduara të neneve 46 dhe 49 të Kushtetutës, si dhe ii) shkeljet e pretenduara të Kushtetutës në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit. Rrjedhimisht, Gjykata në vazhdim do t'i shqyrtojë këto pretendime veç e veç.

i) *Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës*

38. Sa i përket shkeljeve të të drejtave të garantuara me nenet 46 dhe 49 të Kushtetutës, Gjykata rikujton edhe një herë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) (d) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (1) (d) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (1) (d) thekson se:

**Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)**

*(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]*

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

39. Gjykata rikujton se bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafin (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës, si dhe në praktikën e saj gjyqësore, vazhdimisht ka theksuar që: (i) palët janë të detyruara të sqarojnë faktet dhe pretendimet në mënyrë të saktë dhe adekuate; si dhe (ii) të dëshmojnë dhe mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave ose dispozitave kushtetuese.
40. Në rastin konkret, parashtuesi theksoi vetëm shkeljet e neneve 46 dhe 49 të Kushtetutës, mirëpo, parashtuesi në kërkesën e tij nuk jep ndonjë arsyetim më të detajuar se si ka ndodhur shkelja e këtyre neneve. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtuesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet K1175/20, cituar më lart, paragrafi 81; K1166/20, cituar më lart, paragrafi 52; K104/21, cituar më lart, paragrafët 38- 39).
41. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtuesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 46 dhe 49 të

Kushtetutës, kërkesa duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar, siç përcaktohet në paragrafin (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

ii) Përkitazi me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit

42. Gjkata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës konsiston në pretendimin se AKP dhe DHPGJS e kanë shkelur Kushtetutën, duke arsyetuar si në vijim: *“Konsiderojmë se AKP është pasuese e Agjencisë së Mirëbesimit e cila ka punuar dhe punon sipas Rregullores së UNMIK-ut, e jo në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, prandaj edhe për këtë arsye konsiderojmë se aktgjykimet janë jolëndore, sepse janë marrë nga organi jokompetent”*.
43. Lidhur me këtë, Gjkata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar dallimin në mes të *“kushtetutshmërisë”* dhe *“ligjshmërisë”* dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë aspekt, dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”*, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
44. Gjkata gjithashtu vazhdimisht ka pohuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo vetë nuk mund të vlerësojë faktet që kanë bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjkata do të vepronte si gjykatë e *“shkallës së katërt”*, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56, dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).
45. Gjkata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me interpretimin e gabuar të ligjeve të aplikueshme nga AKP-ja dhe DHPGJS-ja.
46. Gjkata vëren se AKP dhe DHPGJS arsyetuan në detaje përse nuk e pranuan kërkesën e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht përse ishte refuzuar kërkesa e tij për dëmshpërblim.
47. Fillimisht, AKP, përmes Vendimit [PNR142-0415], refuzoi si të pavlefshme kërkesën e parashtruesit, me arsyetimin se, *“[...] Autoriteti i Likuidimit*

konstatoi që Shtojca e Ligjit të AKP-së (Ligji Nr. 04/L-034), neni 40.1.6.2 parasheh që punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse “pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP-ja sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në”. Autoriteti i Likuidimit vlerësoi se në kohën e likuidimit, i cili është i veprimi i Agjencisë mbi Ndërmarrjen, parashtuesi i kërkesës nuk ishte në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Marrëdhënia e punës së parashtuesit nuk u shkëput për shkak të hyrjes së N.Sh.-së në likuidim, por shumë më herët“.

48. Më tej, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit [C-VI-17-0291], vërtetoi në tërësi Vendimin [PNR142-0415] e AKP-së, të 28 shkurtit 2020, me arsyetimin se, “[...] Ankuesi pohon se ishte punëtor i NSH-së gjer me 21 shkurt 2002. Bazuar në nenin 40.1.6.2 të Ligjit për AKP (Ligji Nr. 04/L-034), ku parasheh se punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse pushohen nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në. Nga dispozitat e lartë cekura punëtori gëzon të drejtën në dëmshpërblim nëse: a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë si rrjedhojë e vendimit për likuidim me 22 shkurt 2017, kur kishte filluar procedura e likuidimit të NSH-së “RILINDJA” Gazeta, b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë e Vendimit të AKP-së dhe c. Ndonjë veprim nga Agjencia lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit, etj. Nga ankesa nuk mund të shihet se ankuesi ka përmbushur njërin nga kushtet e parapara ligjore, me qëllim që të gëzonte të drejtën në kompensimin e të ardhurave personale [...]”.
49. Në fund, për këto pretendime të parashtuesit ka vendosur edhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, i cili e refuzoi ankesën e parashtuesit dhe vërtetoi Vendimin e AKP-së dhe Aktgjykimin e Dhomës së Specializuar të DHPGJS-së.
50. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet Aktgjykimit [AC-I-20-0254] të Kolegjit të Apelit, ku është arsyetuar se “Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e datës 12 prill 2017, me vendimin PRN142-0415 të datës 23 maj 2017, refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se paditësi nuk ishte në marrëdhënie pune në kohën e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së, dhe ai nuk ka ofruar asnjë provë se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i veprimit të AKP-së”.
51. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës ka përfituar nga procedura kontradiktore dhe ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t’i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t’i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz*

kundër Spanjës, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, të cituar më lart, paragrafi 58).

52. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për interpretimin e gabuar të ligjit, përkatësisht për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut, nuk mbështeti mjaftueshëm dhe as nuk argumentoi para Gjykatës, se si ky interpretim dhe zbatim i ligjit nga AKP dhe DHPGJS, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se AKP dhe DHPGJS i kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe i kanë arsyetuar të njëjtat, si dhe kanë arsyetuar qartë përse kërkesa e parashtruesit për dëmshpërblim nuk është e pranueshme (shih, në këtë aspekt, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtrues: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
53. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të Kushtetutës, për shkak të interpretimit të gabuar dhe zbatimit të gabuar të ligjit në fuqi janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

54. Si përmbledhje, Gjykata, duke marrë parasysh elaborimet dhe konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin që:
- i. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 46 dhe 49 të Kushtetutës hyjnë në kategorinë (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe, si të tilla, në baza kushtetuese duhet të shpallen qartazi të pabazuara.
 - ii. pretendime të parashtruesit të kërkesës për zbatimin e gabuar të ligjit, përkatësisht të Rregullores së UNMIK-ut hyjnë në kategorinë (i) që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*” dhe, si të tilla, në baza kushtetuese duhet të shpallen qartazi të pabazuara
55. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në rregullin 39 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) dhe (2), më 11 maj 2022, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljajti



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani